

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E HËNË 23 MAJ 2022

Të nderuar kolegë,

Butrinti, si pasuri kulturore dhe arkeologjike me një rëndësi universale, meriton jo vetëm këtë debat, por meriton edhe këtë tërësi kornizash që po vendosim sot së bashku, të cilat unë do të doja t'i lista për të ilustruar edhe një herë atë që kolegët e kanë thënë me radhë në këto dy orë diskutimesh të bëra, të çelura nga pyetja e zotit Majko. Sot ky parlament i nderuar dhe maxhoranca kanë mundësinë të vendosin kornizën e parë ligjore dhe rregullative, që vihet në zbatim të ligjit dhe të rregullave përkatëse. Kolegët e nderuar, që sot janë ulur në anën tjetër, ndoshta e kundërshtojnë apo dyshojnë për projektin që kemi përpara, por në këtë parlament në vitin 2018 është votuar ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i cili në pikën 5 të nenit 172 parashikon përkatësisht: “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme”.

Pra, ministria ka detyrimin ligjor të lidhë marrëveshje me një fondacion të posaçëm dhe këtë gjë e parashikon ligji i miratuar nga Kuvendi. Në zbatim të ligjit ka dalë një vendim i Këshillit të Ministrave, ku sërish shteti vendos rregullat e administrimit të pasurive kulturore publike dhe funksionimin e subjekteve juridike. Pra, shteti ka vendosur rregullat e administrimit të këtyre pasurive dhe fondacionet e posaçme që krijohen duhet të zbatojnë rregullat e vendosura nga shteti. Ka edhe një akt të tretë, që është udhëzim i ministrit: “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”. Shteti sërish ka vendosur mënyrën se si kalohet prona në administrim dhe si do të menaxhohet nga fondacionet e posaçme, që është kërkesë ligjore.

Kolegë të nderuar,

Nëse ne kemi probleme me ligjin, me vendimin e Këshillit të Ministrave apo me udhëzimin e ministrit, ka vetëm një vend ku shkohet dhe sfidohen këto akte të shtetit shqiptar, që është gjykata. Për ligjin nuk bëhet zhurmë, ligji zbatohet. Zonja Ministre, ne sot kemi për detyrë ta çmojmë këtë marrëveshje. Me një sugjerim apo këshillë, që përdoret në komunitetin e atletëve, thonë se kur dikush bën gjysmë maratonë, më mirë të thuhet se përfundoi gjysmë maratonë, se të thuhet që e la përgjysmë. Në të njëjtën mënyrë, kolegët, që kanë miratuar një ligj të tërë, sot duhet ta zbatojnë. Më mirë të thonë

“luftova për përmirësimin e marrëveshjes për Butrintin”, por jo “kundërshtova marrëveshjen për Butrintin”, sepse është kërkesë ligjore. Kjo është korniza e parë.

Zonja Ministre, si banor, por edhe si deputet i privilegjuar në zonën e Pezës dhe atë të Ndroqit, mezi pres të pasohen fondacione posaçme për kalanë e Ndroqit, për kalanë e Dorëzit apo për pasuri të tjera, për të cilat jam i vetëdijshëm se nuk kanë rëndësinë e Butrintit, por jam i bindur se ligji parashikon që pasuri të tilla të menaxhohen. Korniza e dytë, që ne sot i vendosim bukurisë dhe unikalitetit të Butrintit, është kontraktuale. Marrëveshja që kemi sot, ka 37 nene dhe 6 anekse. Me anë të kësaj marrëveshjeje fondacioni i krijuar posaçërisht është për menaxhimin e Butrintit dhe ka kornizë strategjike. Në marrëveshje parashikohet se si kjo pasuri vihet në dispozicion, e posedon fondacioni, por nuk e ka në pronësi dhe nuk mund ta tjetërsojë.

Pra, kolegë të nderuar, fondacioni e ka në posedim pasurinë, ka të drejtë ta gëzojë, ta përdorë, ka të drejtë të shtojë vlerat e Butrintit përmes marrëveshjes, por nuk mund ta tjetërsojë atë. Pikërisht këtu dua t’i jap përgjigje pyetjes pse ky fondacion është i posaçëm, pra pse në ligj parashikohet ngritja e një fondacioni të posaçëm? Ky fondacion është i posaçëm, sepse bëhet pikërisht dhe vetëm për Butrintin. Unë do të kisha shumë dëshirë që paratë e Butrintit të investoheshin në kalanë e Ndroqit, në kalanë e Dorëzit, ose në kalanë e Beratit, nëse doni, por nuk mundemi, sepse ato para do të përdoren vetëm për Butrintin. Po ashtu, është i posaçëm, pasi është fondacion shqiptar, i krijuar në juridiksionin shqiptar, i krijuar nga shteti shqiptar dhe jep llogari para ligjeve të Shqipërisë dhe në këtë parlament.

Tjetra, është fondacion administrator, ku çdo qindarkë e fituar apo e dhuruar do të administrohet vetëm për të mirën e Butrintit, menaxhimi i të cilit bëhet në mënyrë të integruar dhe në përputhje me standardet e UNESCO-s, sepse konservohen, mbrohen dhe rriten vlerat kulturore të Butrintit. Në legjislacionin tonë, në traditën e të drejtës shqiptare, ka vetëm një mënyrë që të mund të drejtpeshosh autonominë dhe mbikëqyrjen. Fondacioni e bën këtë gjë, ndaj shteti ka krijuar këtë njësi të veçantë për menaxhimin e Butrintit, e cila është autonome, mund të rrisë të ardhurat, mund të pranojë dhurata, mund të përdorë asete për të mirën e qëllimit, për të cilën është ngritur, që është Butrinti dhe vetëm Butrinti, por, nga ana tjetër, fondacioni do të japë llogari, do të jetë i mbikëqyrtur. Çdo muaj qershor fondacioni do të dalë përpara njësisë së monitorimit dhe do të japë llogari për çdo qindarkë, për çdo vizitor që ka hyrë dhe për të gjitha asetet e veta, ndaj ka nevojë edhe për autonomi, edhe për mbikëqyrje.

Të dashur kolegë, nëse nuk do të ketë autonomi, neve na jepet mundësia të marrim edhe një varrmihës popullor, të shpallur "arkeolog", dhe të zëvendësojmë drejtorin, profesorin e nderuar arkeolog, dhe ta heqim nga puna. Korniza e tretë është strategjike. Ne kemi vendosur ta menaxhojmë Butrintin bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas modelit evropian. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është krijuar nga dy palë: nga shteti shqiptar dhe Fondi Amerikan i Zhvillimit, i cili është përfaqësues i shtetit amerikan, janë para të taksapaguesve amerikanë. Këto dy njësi kanë krijuar këtë fondacion. Ne kemi vendosur që me amerikanët të ndjekim modelin evropian, e theksoj. I dëgjova me vëmendje kolegët, që thanë charity. Charity, në juridiksionin anglez, i cili është juridiksion unik, është organizatë jofitimprurëse dhe në juridiksionin shqiptar organizatat jofitimprurëse janë: fondacionet, shoqatat, qendrat. Pra, është ekzaktësisht i njëjti model.

Së fundi, dua t'ju them: ne do të bashkëpunojmë patjetër me partnerët tanë strategjikë për të ruajtur, për të konservuar dhe për të shtuar vlerat e Butrintit, por ju ndërkohë jeni duke ruajtur konservuar dhe duke shtuar disa vlera historike të forcës suaj politike, tërësisht me forcat tuaja, duke vendosur në mes të mauzoleumit tuaj një relikë historike, që partnerët tanë e kanë shpallur non grata. Faleminderit!